



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 31, datë 25/07/2025

“PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE PASURIA ME NR. 267/26, LLOJI PASURISË ARË, ME SIPËRFAQE 9000 M2, ME INDEKS HARTE KJ-34-100-(50-C), ZK 2291, PASURI E REGJISTRUAR NË ASHK, NË PRONESI TË BASHKISË KAVAJË

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja (b), nënpika 1.2 shkronja “a”, “c”, nenit 18 pika 2, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55 pika 4, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr. 8312, datë 26.3.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar, të Vendimit nr. 531, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave “Për tokat bujqësore të pandara”, Udhëzimit Nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, i ndryshuar, VKM nr. 370, date 30.01.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Golem të qarkut të Tiranës”, shkresës së sjellë nga DAMT me nr. 1111/1 prot date 24.11.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të radhës mori në shqyrtim këtë projekt-vendim dhe:

VENDOSI:

1. Miratimin për dhënien me qira të tokës bujqësore për pasurinë nr. 267/26, lloji pasurisë are, me sipërfaqe 9000 m2, me indeks harte KJ-34-100-(50-C), ZK 2291 Kryemedhenj, Njesia Administrative Golem
2. Afati për dhënien me qera do të jetë në përputhje me parashikimet e kreut IV të Udhëimit nr. 1 datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” i ndryshuar, në varësi të kulturave bujqësore për të cilat do të merret me qira kjo pasuri.
3. Ngarkohet Drejtoria e Kadastres Urbane, Menaxhimit të Aseteve Publike, Drejtoria e Burimeve Ekonomike për zbatimin e këtij projektvendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Tiranë.



Sekretari i Këshillit Bashkiak
MERI BITURKU

Miratuar me vota	<u>26</u>
Vota Pro	<u>26</u>
Vota Kunder	<u>-</u>
Vota Abstenim	<u>-</u>
Zbardhur me datë	<u>28/07/2025</u>

KRYETAR
RUDIN HYLLIU

